



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK TEPELENË

Nr. 258/1prot.

Tepelenë, më 29.02.2024

V E N D I M

Nr. 18, datë 27.02.2024

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 15, DATË 27.02.2020, TË KËSHILLIT TË BASHKISË TEPELENË, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME TË KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, nenit 54, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, lligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjit nr.44, datë 30.04.2015 “ Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Këshilli bashkiak,

V E N D O S I:


1. Të miratoj disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr 15 datë, 27.02.2020 “Për miratimin e Rrgullores së Brendshme të Këshillit Bashkiak Tepelenë”, si më poshtë:

Neni 33

Emërtimi i Komisioneve të Përhershëm

Këshilli i Bashkisë ka **6 (gjashtë)** Komisione të Përhershme të emëruara si më poshtë:

- 1.1 Komisioni i Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare, Komisioni i Etikës, Standarteve dhe Apelimeve 3(tre) anëtare/ë.
- 1.2 Komisioni i Financave Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjiktë Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare, Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve, Komisioni i Ekonomisë Vendore, Turizimit dhe Zhvillimit Rural, 3(tre) anëtare/ë.
- 1.3 Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit, Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit, Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut, 3(tre) anëtare/ë
- 1.4 Komisioni i Shëndetësisë, Veterinarisë, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit 3(tre) anëtare/ë.



1.5 Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes, Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve si Komisioni i Qeverisë Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit, 3 (tre) anëtare/ë.

1.6 Komisioni i integritit europian dhe mardhëniet me jashtë, 3 (tre) anëtare/ë.

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miraturar me 14 (katërmëdhjetë) vota

Vota Pro 14 (katërmëdhjetë)

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur më datë 29.02.2024

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

